



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 161/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.04.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Lurimi” ShPK, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-88298-02-25-2021, me objekt: “Pyllëzimi me llojin ”Akacie”, në ngastrën Nr. 78/c ekonomia pyjore - Bushtrice”, me fond limit 4.237.844 lekë (pa TVSh) zhvilluar më datë 11.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Ankimues: “Lurimi” ShPK.
Adresa: Lagjja Drita, Burrel.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës.
Adresa: Sheshi “Skenderbej“, Lagjja Nr.5, Kukës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur në të njëjtën datë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar përmbajtjen e ankimit lidhur me paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.02.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-88298-02-25-2021, me objekt: “*Pyllëzimi me llojin ”Akacie”, në ngastrën Nr. 78/c, ekonomia pyjore - Bushtrice*”, me fond limit 4.237.844 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 11.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

II.2. Në datën 11.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.03.2021, operatori ekonomik “*Lurimi*” ShPK pretendon se është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

Operatori ekonomik është debitor pranë DR Tatimore Burrel.

Operatori ekonomik ka paraqitur ofertën anomalish të ulët.

II.4. Referuar dokumentacionit dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzuar në rrugë postare më datë 09.04.2021 (kod gjurmimi: RR623507300AA) konstatohet se me datë 29.03.2021, nga ana e autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa e këtij operatori ekonomik, i cili kundërshtonte arsyet e skualifikimit me pretendimet si më poshtë vijon:

Më dt.23.03.2021 në faqen elektronike të APP-së njoftohet operatori ekonomik “Lurimi” ShPK për refuzim të ofertës ekonomike me objekt: Pyllëzimi me llojin “Akacie”, në ngastrën Nr. 78/c, ekonomia pyjore - Bushtricë, me argumentin joligjor të AK si më poshtë:

- *Operatori ekonomik është debitor pranë DR Tatimore Dibër.*
- *Operatori ekonomik ka paraqitur ofertën anomalisht të ulët;*

I- Rrethanat e faktit.

Me tu njohur me publikimin e objektit të prokurimit referuar legjislacionit Shqiptar për konkurrimin e lirë dhe të ndershëm “Lurimi” ShPK Mat vazhdoi procedurat e ligjshme brenda afatit ligjor siç dhe janë dokumentacioni i bashkëlidhur në faqen elektronike të APP për objektin: Pyllëzimi me llojin “Akacie”, në ngastrën Nr. 78/c, ekonomia pyjore Bushtricë,

E përgjithshme:

Për plotësimin e dokumentacionit sipas DS të tenderit, të publikuara për çdo pikë nga AK Bashkia Kukës janë plotësuar pikë për pikë nga OK “Lurimi” ShPK Mat.

Rrethanat e çështjes.

Në Dokumentet Standarde të Tenderit seksioni I, pika 4.2 thuhet shprehimisht dhe pa të drejtë interpretimi

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët ✓

Argumentimi ligjor i OP “Lurimi” ShPK Mat, se përse ka marrë pjesë dhe ka konkurruar me çmimin me vlerë 2.661.681 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSh.

Në shtojcën ekstra të kërkuar nga AK bashkia Kukës për pjesë të ofertës ekonomike është argumentuar dhe analiza ekonomike për çdo njësi sipas proceseve të punës, gjë e cila është shumë e qartë për një KVO nëse kanë profesionalizmin për analiza ekonomike dhe argumentime teknike dhe referuar Ligjit të PP argumentimi kërkon baza teknike, të cilat nuk janë bërë dhe argumentuar nga AK, por janë përdorur masa drastike diskriminuese dhe madje duke ndikuar drejtpërdrejt në fryrjen e shpenzimeve apo dhënien e të drejtës së pamërituar të të ashtuquajturve shoqata, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me punë shumë të rëndësishme në punime në pyje apo kullota, ndonëse shoqatat veprojnë nëpërmjet OJF-ve të ndryshme nëpër institucione po të ndryshme, por kjo nuk është pjesë e OK, por e Gjykimit të KPP-së mbi rrethanat e këtij vlerësimi të kësaj pike diskriminuese.

Në pagën për ditë pune në shtojcën ekstra është përcaktuar 1450 lekë për ditë pune pa sigurime shoqërore siç dhe kërkohet në shtojcën përkatëse nga AK.

Me pagë mesatare në ditë për 22 ditë pune, punonjësi është në vlera sipas Legjislacionit Shqiptar me vlerë ditë pune 1699.15 lekë në ditë dhe për 22 ditë pune 37277.3 lekë në ditë.

Përveç kësaj duke marrë në konsideratë dhe selinë e kompanisë “Lurimi” ShPK Mat me një eksperiencë 30 vjeçare në këtë fushë, ka kantieret e saj të lëvizshme të përhershme për realizimin e punimeve pyjore të pyllëzimit dhe i ka realizuar ato me sukses në çdo vit.

Përveç pagës së punëmarrësit, punonjësit trajtohen për periudhën e punimeve me dieta ushqime suplementare, transportin, akomodimin dhe rikthimin në selinë e kompanisë me të përfunduar procesi i pyllëzimit.

Kompania konkurruese “Lurimi” ShPK ka vendosur një çmim për njësi për koston e fidanëve të llojit akacie që do të përdoret për material mbjellës për pyllëzime në vlerë 70 (shtatëdhjetë) lekë për 1 copë fidan.

Kompania “Lurimi” është kompani e cila disponon fidanishten më të madhe në zonën verilindore për prodhimin dhe tregtimin e fidanëve pyjorë, duke trajtuar një numër të konsiderueshëm dhe si e tillë ka analizën ekonomike, teknike, e profesionale, se përse ofrohet një çmim i një vlere prej 70 lekë për një copë fidan.

Fidanët e llojit akacies të nderuar KPP, siç dhe e kanë kërkuar vetë AK Bashkia Kukës, i kanë kërkuar 1 deri në dyvjeçare, që do të thotë, se çmimi nuk mund të jetë i barabartë si për një fidanë 1 vjeçar, si për fidanë 2 vjeçar apo më shumë se sa dyvjeçar, ndaj nga ana teknike, profesionale, standarde e cilësisë së fidanëve është në parametrat shumë korrekt dhe të pranueshme dhe besueshme në realizimin me sukses të punimeve.

Kompania nuk ka kosto që rëndojnë transportin e fidanëve nga selia e kompanisë dhe deri në objektin e pyllëzimit, pasi kompania ka kapacitetet në pronësi për transportin apo lëvizjen e rrjedhshme të materialit mbjellës deri në realizimin e kontratës me sukses.

Kompania ka koston e saj minimale në trajtimin, rritjen, zhvillimin e fidanëve pyjore, duke patur një impiant modern të trajtimit të farërave e fidanëve sipas standardeve ndërkombëtare gjë e cila ka bërë, që kompania “Lurimi” ShPK të furnizojë kompanitë ndërkombëtare më me zë, që operojnë në Shqipëri siç dhe është gazsjellësi TAP.

ANALIZË PËR ÇMIMIN PËR NJËSI për pagë
ditë pune pa përfshire çmimin e fidanëve por vetëm paga për ditë pune

Nr.	Punime Pyllëzimi	Ditë pune	Paga ditë pune	Sig shoqër	Pa sig.sho	Sig.sh	Me sig.	Paga mes/dit
1	Proces pune total	22	1450	16.70%	31900	5327.3	37227.3	1692.15

Për shtojcën ekstra të AK për grafikun e punimeve është një argumentim i qartë i OK që çuditërisht ndonëse AK e ka kërkuar në DS, por nuk e ka marrë në konsideratë, pasi grafiku i punimeve është një argumentim shumë i qartë që i bën OK, se përse është paraqitur kjo ofertë me këtë çmim dhe e argumentuar në afate ligjore, teknike, të realizimit të objektit.

Në shënimet shpjeguese të grafikut të punimeve është shënuar me detaje për çdo operacion punimesh, sa do të zgjasin dhe kur do të jetë momenti final i marrjes në dorëzim.

Një detajim të grafikut të punimeve do jua bashkëlidhim ju KPP për të verifikuar ligjshmërinë e këtij argumentimi.

Lidhur me këtë pikë të ofertës anomalisht të ulët, kjo nuk qëndron për vetë faktin dhe argumentimin që ju dhamë më lart.

- *Shprehim shume besim në vlerësimin e KPP-së për këtë pikë.*

Lidhur me detyrimet ndaj AR Tatimore Dibër.

Është një diskriminim total i OK për vetë faktin se duhet që të nxiret një argumentim i jashtëligjshëm për ti dhënë mundësi konkurrencës së pandershme.

Në faqen e APP-së është bashkëlidhur sipas shtojcës 4 deklarata e OK dhe përveç kësaj OK nga faqja e Tatimeve në E-Albania me vulë elektronike është bashkëlidhur vërtetimi me nr. T03642836, dt.02.03.2021 ku rezulton: Se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në dt. 02.03.2021 ora 07.54.23 sek. Oferta është paraqitur më dt.09.03.2021, ora 18.53 sipas referencës 88298-02-25-2021.

E njëjta gjë është dhe për formularët për dokumentin T03654634, dt.3.03.2021 ku oferta është paraqitur me dt. 09.03.2021 ora 18.53 sipas referencës 88298-02-25-2021.

Sa më sipër dua t'ju bëj me dije KPP, se afati i pagesës së detyrimeve tatimore ka një kalendar dhe nëse do të ekzistonin, është sipas afateve ligjore dhe kalendarit të deklarimeve në tatime dhe kalendarit të pagesës së detyrimeve që legjislacioni shqiptar ka përcaktuar dhe nuk është AK që bën ndryshimet e këtij kalendari, që do të thotë se kompania "Lurimi" nuk e ka shkëlur asnjë afat pagese referuar kjo dhe afatit të fundit të bashkëlidhjes së dokumentacionit në faqen e APP për objektin e prokuruar. Duke pasur besim të plotë në një vlerësim ligjor e korrekt të KPP-së, presim përgjigje.

II.5. Me anë të shkresës nr. 1276 prot, datë 02.04.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë.

II.6. Në datën datë 09.04.2021 (kod gjurmimi: RR623507300AA) operatori ekonomik "Lurimi" ShPK ka paraqitur ankesë në rrugë postare në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur

Arsyeton

III.1. Në datën 26.02.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-88298-02-25-2021, me objekt: “*Pyllëzimi me llojin ”Akacie”, në ngastrën Nr. 78/c, ekonomia pyjore - Bushtrice*”, me fond limit 4.237.844 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 11.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

III.1.1. Në datën 11.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.2. Në datën 23.03.2021, operatori ekonomik “*Lurimi*” ShPK pretendon se është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

Operatori ekonomik është debitor pranë DR Tatimore Burrel.

Operatori ekonomik ka paraqitur ofertën anomalish të ulët.

III.1.3 Referuar dokumentacionit dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzuar në rrugë postare më datë 09.04.2021 (kod gjurmimi: RR623507300AA) konstatohet, se me datë 29.03.2021, nga ana e autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa e këtij operatori ekonomik, i cili kundërshtonte arsyet e skualifikimit.

III.1.4. Me anë të shkresës nr. 1276 prot, datë 02.04.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë.

III.1.5. Në datën datë 09.04.2021 (kod gjurmimi: RR623507300AA) operatori ekonomik “*Lurimi*” ShPK ka paraqitur ankesë në rrugë postare në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor, ku pjesë e dosjes ishte Formulari i Ankeses pranë autoritetit kontraktor datë 25.03.2021, Vendim “*Për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga subjekti “Lurimi” ShPK për procedurën e prokurimit me objekt: “Pyllëzim me akacie në ngastrën nr.78/C, ekonomia pyjore Bushtricë” nr.42, datë 02.04.2021 i autoritetit kontraktor Bashkia Kukës, Formulari i Ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik datë 07.04.2021 dhe Mandatit bankar datë 25.03.2021, lëshuar nga Raiffaisen Bank, me numër reference: 0014, lëshuar nga Dega 028 (Dega Abdyl Frashëri) me përfitues Dega e Thesarit Tiranë, për numrin e llogarisë: 010403078.*

III.1.6. Nga verifikimi i mandatit bankar të sipërpërmendur u konstatua se ky mandat i referohet pagesës paraprake të tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Lurimi” SHPK pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 25.03.2021 dhe për të cilën ky institucion është shprehur me vendimin nr.143, datë 29.03.2021, duke e rrëzuar ankesën dhe sipas parashikimeve të pikës 5, të VKM nr.261, datë 17.3.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, kjo pagesë është derdhur në Buxhetin e Shtetit, pra Formulari i Ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik datë 07.04.2021 nuk është i shoqëruar me mandatin bankar të vlefshëm për pagimin e tarifës për ankimin e procedurës së mësipërme të prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 10, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

“10. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifatat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Gjithashtu në nenin 20, pika 2 dhe nenin 26 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” përcaktohet si më poshtë vijon:

Neni 20

Forma dhe përmbajtja e ankesës

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimesit;

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi;

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes..

Neni 26

Verifikimi i kushteve formale

1. Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 5 ditëve nga regjistrimi i ankesës me qëllim shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b) legjitimimin e ankuesit;

c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d) elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 20 të kësaj rregulloreje.

2. Relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës dhe nëse autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Ai i relatton Komisionit rezultatet e verifikimit.

3. Komisioni voton sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje dhe vendos:

a) Mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni ia njofton vendimin ankimuesit brenda 5 ditëve, duke i treguar edhe të drejtën për t'u ankuar në gjykatë, si dhe autoritetit kontraktues me qëllim

që ky i fundit të marrë masat për vazhdimin e procedurës së prokurimit publik nëse e ka pezulluar atë;

b) Kalimin e ankesës për shqyrtim, duke marrë një prej vendimeve të parashikuara në nenin 28 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, me kërkesë të relatorit të bazuar në aktet e bashkëlidhura ankesës, Komisioni vendos edhe nëse duhet marrë mendimi i specialistëve/ekspertëve të pavarur, si dhe njofton ankuesin për afatin e parapagimit të ekspertëve. Njoftimi përmban edhe paralajmërimin se në rast të mosparapagimit të ekspertizës në afatin e caktuar, Komisioni nuk thërret dhe nuk merr si provë ekspertizën e kërkuar.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ dërguar me rrugë postare, si dhe mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankesa e datës 07.04.2021 e shoqërisë "Lurimi" ShPK nuk plotëson kushtet formale dhe përmbajtjen, pasi nuk ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Në interpretimin gjuhësor të nenit 26, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", që ankesa e operatorit ekonomik të merret në shqyrtim nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik duhet që fillimisht të përmbushë kushtet formale dhe përmbajtjen, ku një nga elementët është mandati i pagesës së tarifës për ankimim sikurse parashikohet dhe në nenin 63/10, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka përmbushur kushtet formale dhe përmbajtjen e ankimit, pasi e ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik të pa shoqëruar me mandatin e pagesë së tarifës së ankimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Lurimi" ShPK, për procedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim", me nr. REF-88298-02-25-2021, me objekt: "Pyllëzimi me llojin

”Akacie”, në ngastrën Nr. 78/c, ekonomia pyjore - Bushtrice”, me fond limit 4.237.844 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 11.03.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 584 Protokolli

Datë 09.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri